


OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM

Në vitin 2000, asambleja më e madhe e kryetarëve të shteteve në histori u mbledh në zyrat e Kombeve të Bashkuara në New York për të miratuar Deklaratën e Mijëvjeçarit, duke angazhuar vendet e tyre në një partneritet të ri global për të ulur varfërinë ekstreme në dimensionet e saj të shumta. Rezultati ishte vendosja e tetë objektivave të zhvillimit, me afat implementimi vitin 2015, të njohur si Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM, siç njihen në anglisht Millennium Development Goals, MDGs).

Ndonëse në këto 15 vitet e fundit u bë një progres i dukshëm në arritjen e OZHM-ve, shumë objektiva nuk u arritën. Për të përshpejtuar progresin dhe avancuar zhvillimin përtej vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 25 shtator 2015 miratoi axhendën e zhvillimit të post-2015, duke vendosur objektivat dhe pikësynimet e reja për 15 vitet e ardhshme.

Axhenda e re përcakton shtatëmbëdhjetë Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat kanë si afat vitin 2030 dhe kërkojnë të ndërtojnë e plotësojnë atë që OZHM nuk e arritën. Në këtë axhendë të re të zhvillimit, uji dhe kanalizimet konsiderohen të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa ato kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore. Kjo është arsyeja pse ujit dhe kanalizimeve i është dhënë një objektivi i posaçëm (OZHQ nr. 6). Ky objektivi i veçantë për ujin dhe kanalizimet është e rëndësishme që të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe adresimin e problemeve globale të ujit.

Nga MDG tek SDG



Burimi: UNDP (United Nation Development Program)

Përgjithësisht, OZHQ-të janë më bashkëpunuese se OZHM-të në shkallë globale. Për shembull, angazhimi i sektorit privat është rritur nëpërmjet iniciativave të ndryshme si UN Global Compact and Impact 2030. Gjithashtu, OZHQ-të janë projektuar për të integruar më mirë parimet dhe standardet e të drejtave të njeriut dhe për këtë arsye përgjithësisht janë më përfshirëse se OZHM-të.

Në vijim, do shqyrtojmë OZHQ numër 6, që i dedikohet ujit dhe kanalizimeve duke shpjeguar kush janë targetet e vendosur dhe rruga për realizimin e tyre dhe shkurtimisht do shqyrtojmë sfidat për implementimin e tij.


A. Cilët janë targetet e reja për ujin dhe kanalizimet?

Objekti i 6-të për Zhvillim të Qëndrueshëm për të siguruar mundësinë e furnizimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë përfshin gjashtë targete teknike dhe dy targete shtese si metoda implementimi.

Targeti 6.1 – Të arrihet akses universal dhe i barabartë me ujë të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë.

Targeti i OZHM për ujë të pijshëm të sigurt është arritur tashme: 90% e popullsisë së botës ka tani akses në burime të përmirësuara uji të pijshëm. Megjithatë në shumë rajone në zhvillim (Azia Qendrore, Afrika Veriore, Oqeania dhe Afrika nën-Sahariane) mbulimi me ujë të pijshëm të sigurt mbetet i ulët dhe 663 milion njerëzve i mungon akses në burime të përmirësuara të ujit të pijshëm. Ky target synon të arrij akses universal në ujë të pijshëm të sigurtë, duke vazhduar përpjekjet e bëra.

OZHQ 6: UJI DHE KANALIZIME



Targeti 6.2 – Të arrihet akses në kanalizime dhe higjenshade adekuate dhe të drejtë për të gjithë

Ndryshe nga uji i pijshëm, targeti i OZHM për kanalizimet nuk është arritur: vetëm 68% e popullsisë së botës përdor një sistem të përmirësuar kanalizimesh. Sot gati 2.4 miliard njerëzve u mungon qasja ndaj kanalizimeve të përshtatshme dhe *largimi sipërfaqësor i ujërave të ndotura* mbetet një praktikë e zakonshme për shumë rajone. Këto targete synojnë të arrijnë akses universal në kanalizime duke rritur përpjekjet e bëra në implementimin e sistemeve sanitare të përmirësuar.

Targeti 6.3 – Përmirësimi i cilësisë së ujit duke zvogëluar ndotjen, duke eliminuar dhe minimizuar lëshimin e materialeve dhe kimikateve të rrezikshme.

Ndotja e ujit është një shqetësim global, pasi ulja e cilësisë së ujit sjell probleme si mjedisore ashtu dhe socio-ekonomike. Pra përmirësimi i cilësisë së ujit dhe i menaxhimit të ujërave të ndotura është i domosdoshëm për të adresuar sfidat me shëndetin, sigurinë në ushqim, varfërinë dhe sfidat mjedisore. Ky target ka për qëllim uljen e ndotjes së ujit në burim duke rritur mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Target 6.4 – Rritja e evidencës në përdorimin e ujit në të gjithë sektorët dhe sigurimi i nxjerrjes dhe furnizimit në mënyrë të qëndrueshëm me ujë, për të adresuar mungesën e ujit.

Nxjerrja e tepërt e ujit shkakton “water stress”¹ si për njerëzit dhe për ekosistemet, e cila rezulton me një kosto të lartë mjedisore. Prandaj në mënyrë që të pakësohet nxjerrja e ujit dhe të sigurohet qëndrueshmëria e burimeve ujore është e nevojshme të përshtaten teknika për kursimin e ujit në të gjithë sektorët: agrikulturë (p.sh. ujitja), përdorimi familjar (p.sh. tualete me shkarkim të reduktuar) dhe industria (p.sh. teknika për ripërdorimin e ujërave të ndotur). Ky target ka për qëllim të sigurojë përdorim të qëndrueshëm të burimeve ujore në këto sektorë duke përmirësuar eficientë.

Target 6.5 – Implementimi i menaxhimit të integruar të burimeve ujore në të gjitha nivelet.

Menaxhimi i integruar i burimeve ujore (MIBU) është një qasje ndërsektoriale ku koordinohet zhvillimi dhe menaxhimi i ujit, tokës dhe burimeve të lidhura me to. Me MIBU mirëqenia ekonomike dhe sociale mund të rriten pa dëmtuar mjedisin. Gjithsesi, implementimi i këtij sistemi është kompleks sepse kërkon krijimin e një mjedisi të përshtatshëm (nëpërmjet kornizës ligjore dhe planifikimit strategjik) dhe me pas krijimin e një strukture institucionale për të mbështetur MIBU. Ky target ka për qëllim të integrojë konceptin e MIBU në politikat e ujit.

¹ Ndoth kur kërkesa për ujë tejkalon sasinë në dispozicion gjatë një periudhe të caktuar, apo kur cilësia e dobët e kufizon përdorimin e tij.

Target 6.6 – Mbrojtja dhe rikthimi në gjendje fillestare i ekosistemeve të lidhura me ujin.

Ekosistemet natyrore si kënetat, pyjet, lumenjtë dhe liqenet janë shumë të çmuara, sa kohë ato sigurojnë shërbime të rëndësishme të ekosistemit në lidhje me sasinë dhe cilësinë e ujit. Por ekosistemet e degraduara humbasin aftësitë ripërtëritëse çka rezulton në pakësimin e cilësisë dhe sasisë së ujit. Këto targete kanë për synim të sigurojnë kapacitetin e mjedisit për të ofruar shërbime që lidhen me ujin duke i dhënë fund prishjes së ekosistemeve nga aktiviteti njerëzor (p.sh. urbanizimi, agrikultura e papërshtatshme dhe ndotja).

Përveç kësaj OZHQ numër 6 përfshin 2 targete që lidhen me metodat e implementimit:

Targeti 6.a – Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mbështetja e vendeve në zhvillim në ngritjen e kapaciteteve për aktivitete dhe programe të lidhura me ujin dhe kanalizimet.

Targeti 6.b – Mbështetja dhe forcimi i pjesëmarrjes së komuniteteve lokale në përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe kanalizimeve.

Këto dy targete janë të nevojshëm për të ndërtuar një bazë të konsoliduar në mbështetje të implementimit të OZHQ numër 6 dhe për të arritur targetet e tij ambicioz për ujë dhe kanalizime. Kjo bazë duhet të përfshij jo vetëm mjetet ekonomike (p.sh. investime të përshtatshme) por edhe faktorë të tjerë kryesore (p.sh. politikat, ngritja e kapaciteteve) ata mund të jenë motori dhe shoferi për të arritur OZHQ.

B. Çfarë sfidash kemi përpara?

Për herë të parë në histori, shtetet kaluan nga një vizion lokal në një vizion global që përfshin të gjitha sfidat e ujit dhe kanalizimeve (jo vetëm mbulimin universal me ujë të pijshëm dhe kanalizime por gjithashtu mbrojtjen e ekosistemeve dhe menaxhimit të integruar të burimeve). Objektiv i ri i caktuar është shumë ambicioz dhe kërkon miratimin e politikave të reja të ujit, monitorimin e vazhdueshëm të progresit të bërë dhe kërkimit të mjeteve më të mira teknike dhe menaxheriale.

Gjithsesi përpos sfidave që na presin, profesionistët e ujit në të gjithë botën janë gati të implementojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe ta bëjnë sektorin e ujit më të qëndrueshëm dhe fleksibël.

OZHQ - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

OZHM - Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

MIBU - Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore